



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1029 / 19 Prot

Tiranë, më 13 / 10 / 2020

VENDIM

Nr. 45, datë 13 . 10 . 2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 1029 Prot., datë 01.09.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, nëpërmjet shkresës datë 14.08.2020, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si vijon:

1. Metodologjinë e vlerësimit të dosjes së dokumentave të dorëzuar nga kandidatët në procedurat e konkurimit për pozicionin e ndihmës inspektorit, sa i takon vlerësimit të arsimit, përvojën, trajnimet të lidhura me fushën etj;
2. Kopje të tabelave të vlerësimit të dosjes së dokumentave për kërkuesen/kandidaten dhe për kandidatët fitues nga jashtë shërbimit civil;
3. Kopje të testimit me shkrim me vlerësimin përkatës të kërkueses/kandidates (testimi sekretuar me numër 4 gjatë procedurave të konkurimit);
4. Kopje të CV-së së kandidatëve nga jashtë shërbimit civil, të shpallur fitues në njoftimin e datës 13.08.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1596/4 Prot., datë 25.08.2020 ka kthyer përgjigje për pikën e parë të kërkesës, si dhe në lidhje me pikat 2, 3 dhe 4 të kërkesës për informacion



ka argumentuar ndër të tjera se: "...Vlerësimi i kandidatëve në procedurën e konkurimit është individual dhe në zbatim të përcaktimeve ligjore për shërbimin civil, konkretisht ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, çdo kandidat njoftohet në mënyrë individuale për vlerësimin me pikë për pozicionin në të cilën ka aplikuar. Në lidhje me kërkesën për vënien në dispozicion të kopjes së tezës, për të ruajtur parimin e barazisë midis kandidatëve, të cilët kanë shprehur interes për të marrë kopje të saj, ajo mund të konsultohet në mjediset e institucionit. Për sa i përket CV-ve, të kandidatëve të cilët rezultuan fitues dhe ka përfunduar procedura e rekrutimit ( të cilët kanë filluar marrëdhëniet financiare në institucion), në zbatim të gërmës d) të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", janë publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në adresën [www.ild.al](http://www.ild.al)".

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesja, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit për pikat 2, 3 dhe 4, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "Ligji nr.119/2014").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", dhe nenin 31/1c të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, Komisioneri me shkresën nr. 1029/1 prot., datë 09.09.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik rivlerësimin e dhënies së informacionit të kërkuar dhe/ose argumentet ligjor përkatës.

Në vijim, me shkresën nr. 1995/1 prot., datë 10.09.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1029/2 prot., datë 14.09.2020, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: "...kërkueses i është vënë në dispozicion informacioni lidhur me pikën e parë të kërkesës. Në lidhje me pikën e dytë konkretisht për vënien në dispozicion të formularit të vlerësimit individual për kërkuesen/kandidaten, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim "ILD") megjithëse i ka garantuar të drejtën e aksesit duke e ftuar kërkuesen për t'u paraqitur personalisht për t'u njohur me mënyrën e vlerësimit, e ka bashkëlidhur një kopje të njëhësuar të këtij formulari nëpërmjet kthim përgjigjes. Lidhur me kopjet e vlerësimit të kandidatëve në procedurën e konkurimit, rikonfirmohet qëndrimi i mbajtur mbështetur në legjislacionin për shërbimin civil ku njoftimi bëhet individualisht për çdo kandidat. Në lidhje me pikën e tretë të kërkesës, kërkueses i është garantuar e drejta e aksesit dhe njohjes me këtë dokument (tezën apo



me çelësin e saj). Gjithashtu, duke qenë se ILD është një institucion i sapo krijuar, vënia në dispozicion e tezës së provimit të kandidatës, do të vështirësonte realizimin e procedurave të mëtejshme të rekrutimeve në institucion. Në lidhje me pikën e katërt, është dhënë informacioni përkatës sa i takon përmbushjes së qëllimit të kërimit të tij, nga ana e kërkueses. Në faqen zyrtare të institucionit [www.ild.al](http://www.ild.al), ku janë publikuar të dhënat në përputhje me nenin 7 pika 1, shkronja d) e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesja ka vijuar ankimin nr. 1029/3 prot., datë 15.09.2020, pranë Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ndjekjen e mëtejshme të procedurave në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, duke pretenduar ndër të tjera se: "Së pari: Lidhur me kërkesën për vënie në dispozicion të kopjes së tezës, për të cilën është ftuar të paraqitet personalisht në ambientet e Zyrës së ILD-së për tu njohur me tezën dhe çelësin e saj, ky argument është i pambështetur në ligj dhe jashtë mundësisë objektive të saj, pasi është në marrëdhënie pune dhe e ka të pamundur të paraqitet brenda të njëjtit orar zyrtar në zyrat e ILD-së.

- Së dyti: ILD, ka refuzuar vënien në dispozicion të kopjeve të vlerësimit të kandidatëve fitues në procedurën e konkurimit, në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". - Gjithashtu, është refuzuar vënia në dispozicion e kopjeve të CV-ve të fituesve në konkurim pranë ILD-së. Pozicioni i Ndihmës Inspektorit, përfshihet në kategorinë e mesme drejtuese II-b dhe si të tillë kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe përfshihen në detyrimet e nenit 7, pika 1, gërma d) e ligjit nr.119/2014. Sa më sipër, zyra e ILD-së duhet të dërgojë Cv-të e Ndihmës Inspektorëve, sipas kërkesës."

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të Ligjit nr. 119/2014, në të cilin parashikohet se: "...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", bazuar dhe në nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore me palët.

Gjithashtu, bazuar në nenet 53, 91 dhe 92 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioneri me Vendimin nr.1029/6 Prot., datë 06.10.2020 "Për zgjatjen e afatit të procedurës administrative", vendosi shtryrjen e afatit të përfundimit të procedurës deri me datë 27.10.2020.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 06.10.2020, me prezencën e ankueses znj. nga njëra anë dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik nga ana tjetër.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër si dhe morën përsipër të vendosin në dispozicion linkun përkatës me informacionin e kërkuar në pikën e katërt të kërkesës për informacion.



Në përfundim të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit i kërkoi përfaqësuesve të Autoritetit Publik për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur brenda datës 07.10.2020, ndërsa ankuesit i kërkoi të identifikojë pikat e kërkesës për të cilat nuk ka marrë përgjigje.

Ankuesja, me e-mail-in datë 06.10.2020 kërkon vijimin e ankimit dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për të dhënë informacionin e kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1995/6 Prot., datë 07.10.2020, argumenton qëndrimin përfundimtar duke sqaruar ndër të tjera se: *"...në lidhje me pikën 2 të kërkesës për vënien në dispozicion të kopjeve të vlerësimit të kandidatëve në procedurën e konkurimit, rikonfirmohet qëndrimi se kjo procedurë rregullohet nga legjislacioni për shërbimin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, sipas të cilit, vlerësimi/njoftimi është individual dhe nuk bazohet në dispozitën përjashtuese të nenit 4, pika 4, shkronja b) i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Në lidhje me pikën 3 të kërkesës, ankueses i është garantuar e drejta e aksesit dhe njohjes me këtë dokument. Ashtu siç edhe u parashtrua në seancën dëgjimore, kjo me qëllim garantimin e barabartë të kandidatëve të cilët kanë marrë pjesë në këtë procedurë rekrutimi dhe kanë kërkuar vënien në dispozicion të kopjes së tezës e kanë konsultuar atë në ambientet e institucionit. Gjithashtu, rikthesohet se Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një institucion i sapo krijuar dhe për të siguruar efikasitetin e procedurave të rekrutimit, vënia në dispozicion e tezës së provimit për kandidatët do të vështirësonte procedurat e mëtejshme të rekrutimeve në institucion duke cenuar në këtë mënyrë funksionalitetin e vetë institucionit. Në lidhje me pikën 4 të kërkesës, mbi vënien në dispozicion të kopjeve të CV-ve të kandidatëve nga jashtë shërbimi civil, të shpallur fitues në njoftimin e datës 13.08.2020, janë publikuar në përputhje me nenin 7, pika 1 shkronja d), e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në linkun <https://ild.al/zyra-e-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë/organika/>.*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion, më konkretisht: *(2. Kopje të tabelave të vlerësimit të dosjes së dokumenteve për kandidatët fitues nga jashtë shërbimit civil dhe 3. Kopje të testimit me shkrim me vlerësimin përkatës të kërkueses/kandidates (testimi sekretuar me numër 4 gjatë procedurave të konkurimit), nuk qëndrojnë.*

Komisioneri vlerëson se, nisur nga informacioni që kërkohet, kjo çështje duhet të trajtohet me ligjin nr. 119/2014, por edhe me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Në parim aksesimi dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.



Në përgjigjen e institucionit konstatojmë se kufizimi i aksesit është bërë në referim të këtij neni, pa marrë parasysh edhe kriteret e tjera ligjore të përpunimit, gjithashtu edhe përcaktimeve ligjore për shërbimin civil, konkretisht ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar.

Duke qenë se në legjislacionin specifik parashikohet që emrat e kandidatëve ose fituesi shpallen në ambientet e institucionit apo në faqen online të tij, pra bëhen të dhëna haptazi publike, atëherë ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar nuk mund të shërbejë si pengesë për dhënien e këtij informacioni.

Për më tepër, kandidatët që shpallen fitues dhe përfundojnë procedurat e emërimit në institucionet publike, që nga ky moment konsiderohen funksionarë publikë, në përputhje me germën “b” të pikës 4 të nenit 4 të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar: “Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre”. Rrjedhimisht, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion informacionin e kërkuar në pikën 2 të kërkesës për informacion, më konkretisht: (2. Kopje të tabelave të vlerësimit të dosjes së dokumenteve për kandidatët fitues nga jashtë shërbimit civil), në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë të të dhënave.

Në lidhje me pjesën tjetër të pikës 2 të kërkesës për informacion, konkretisht: 2. Kopje të tabelave të vlerësimit të dosjes së dokumenteve për kërkuesen/kandidaten, rezulton se Autoriteti Publik pas ndërhyrjes së Komisionerit, ka përmbushur detyrimin për dhënie informacioni, konfirmuar kjo edhe nga ankuesja.

Në lidhje me pikën 3 të kërkesës në të cilën kërkohet: Kopje të testimit me shkrim me vlerësimin përkatës të kërkueses/kandidates (testimi sekretuar me numër 4 gjatë procedurave të konkurimit), Komisioneri vlerëson se, e drejta e aksesit të subjektit të të dhënave (në rastin konkret ankueses), e parashikuar në nenin 12 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, mund të kufizohet nga institucioni publik (në cilësinë e kontrolluesit) në rastet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni ose bazuar në dispozita të legjislacionit të posacëm.

Bazuar në sa më sipër, argumentet e paraqitura nga kontrolluesi në këtë rast nuk reflektojnë kriteret apo bazën ligjore mbi të cilat është mbështetur refuzimi i aksesit.

Gjithashtu, Komisioneri thekson se ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nuk parashikon të drejtën e kontrolluesit për të përcaktuar mënyrën e ofrimit apo garantimit të aksesit në të dhënat personale nga ana e subjektit të të dhënave. Përkundrazi, kjo e drejtë duhet të garantohet nga ana e



kontrolluesit në përputhje me kërkesën e paraqitur nga subjekti i të dhënave personale (në këtë rast ankuesi).

Jo vetëm fryma, por edhe përmbajtja konkrete e germës “b” të pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, imponon detyrimin e kontrolluesit për të vënë në dispozicion të subjektit të të dhënave, të dhënat personale të këtij të fundit, në formën e kërkuar nga ky i fundit, duke parashikuar qartësisht se “Çdo person ka të drejtë pa pagesë që, me kërkesë me shkrim, të marrë nga kontrolluesi [...] a) në një formë të kuptueshme, të dhënat personale [...]”.

Sa më sipër, Komisioneri e gjen të bazuar, si dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, kërkesën e ankueses për të “marrë nga kontrolluesi” të dhënat e saj personale.

Në lidhje me pikën 4 të kërkesës për informacion, “Kopje të CV-së së kandidatëve nga jashtë shërbimit civil, të shpallur fitues në njoftimin e datës 13.08.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, konstatohet se, Autoriteti Publik në përgjigjen fillestare ka referuar faqen zyrtare të institucionit. Në vijim pas zhvillimit dhe sqarimit në seancën dëgjimore ka vendosur në dispozicion të ankueses adresën e saktë të faqes se ku gjendet informacioni, në përputhje me pikën 2 të nenit 16 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin parashikohet se: “Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...”. Për sa më sipër, ka përmbushur në këtë mënyrë detyrimin për dhënie informacioni.

E drejta për informimin, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe për ti shërbyer nxitjes së integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: “Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e Ligjit nr. 119/2014 parashikon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre është në interesin publik.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 1029 Prot., datë 01.09.2020 të znj. *[Emri i fshehtë]*, ndaj Autoritetit Publik “Inspektori i Lartë i Drejtësisë”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat 2 (pjesërisht) dhe 3 të kërkesës për informacion datë 14.08.2020, konkretisht: (2. *Kopje të tabelave të vlerësimit të dosjes së dokumenteve për kandidatët fitues nga jashtë shërbimit civil dhe pikën* : 3. *Kopje të testimit me shkrim me vlerësimin përkatës të kërkueses/kandidates, testimi sekretuar me numër 4 gjatë procedurave të konkurimit*), brenda datës 20 . 10 .2020.
3. Rrëzimin e ankesës për dokumentacionin e kërkuar në pikat 2 dhe 4 të kërkesës për informacion datë 14.08.2020, konkretisht (2. *Kopje të tabelave të vlerësimit të dosjes së dokumenteve për kërkuesen/kandidaten dhe 4. Kopje të CV-së së kandidatëve nga jashtë shërbimit civil, të shpallur fitues në njoftimin e datës 13.08.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*).
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 13 . 10 .2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

